



Ne. 6/prot
Dt. 16/08/2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 6 Datë 14. 08. 2018

“PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE ME OBJEKT “NDËRTIM I GODINËS SË SHËRBIMIT TË PIKËS SË KALIMIT KUFITAR TË HANIT TË HOTIT”

Në mbështetje të nenit 4, pika 8 të ligjit Nr. 6/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"; V.K.M. Nr. 416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 të K.K.U. “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor”, dhe Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016 të K.K.U. “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor”, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V E N D O S I :

1. Miratimin e autorizimit “Për përdorim burimi ujor”, për veprimtari ndërtimore në brigje, Drejtorisë së Përgjithshme të Kufirit dhe Migracionit, me objekt “Ndërtim i godinës së shërbimit të pikës së kalimit kufitar të Hanit të Hotit”.
2. Ngarkohet Agjencia e Basenit Ujor drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR
Raimonda GURI



KRYETAR
Çesk MILLJA

